



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 6 të Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët, nenit 3,4 dhe 6 të Ligjit Nr.03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugët Nr.2003/11, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.46/15 janar 2009 dhe nenit 9 shkronja f), nenit 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29. 06. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR HAPJEN E TRASESË SË RRUGËS NË ZONËN KADASTRALE KONJUH

Neni 1

1.Me këtë Vendim hapet traseja e rrugës me gjërësi prej 5 metrave në pjesët e parcelave kadastrale si në vijim:

- 1.1 P-71409036-00164-2 në vendin e qujtur "Branjesh" me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 620m² (sipërfaqe e tërsishme 13756m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.Kuvendi Komunal Lipjan.
- 1.2 P-71409036-00164-17 në vendin e qujtur "Branjesh" me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 922m² (sipërfaqe e tërsishme 10093m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.Kuvendi Komunal Lipjan.
- 1.3 P-71409036-00164-25 në vendin e qujtur "Branjesh" me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 1292m² (sipërfaqe e tërsishme 8061m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.Kuvendi Komunal Lipjan.
- 1.4 P-71409036-00164-24 në vendin e qujtur "Branjesh" shfrytëzimi aktual oborr, shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe prej 489m² (sipërfaqe e tërsishme 28910m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.KK Lipjan shfry.99 vite N.PQ "Lesna" Sh.p sipas kontratës 1-464-153 dt.26.07.2006.
- 1.5 P-71409036-00164-23 në vendin e qujtur "Branjesh" me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 1197m² (sipërfaqe e tërsishme prej 15000m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.KK Lipjan shfry.99 vite Standard Benz Sh, sipas kontratës 1-464-154 dt. 26.07.2006.

1.6P-71409036-00164-28 në vendin e quajtur "Branjesh" me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 569m² (sipërfaqe e tërsishme 15000m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.KK Lipjan shfry.99 vite UBT Sh.p sipas marrëveshjes nr.ref.16303 009 058 611 tetor 2009.

Neni 2

Hapja e trasesë së rrugës në pjesët e parcelave kadastale bëhet me qëllim që të iu mundësohet titullarëve të pronave private të kanë qasje në pronat e tyre e që për momentin këto prona nuk kanë qasje në rrugë. Gjithashtu rruga e cila do të hapet do të shërbejë edhe për bizneset.

Mundësia e hapjes së trasesë së rrugës së re ekziston pasi janë dhënë pëlqimet nga shfrytëzuesit e pronave komunale siq është përcaktuar në nenin 1 pargrafi 1.4, 1.5, 1.6 të këtij vendimi.

Neni 3

Kushtet ndërtimore dhe procedurat tjera që rezultojnë në zbatimin e këtij vendimi do të jenë në harmoni me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për caktimin e kufijve të rrugës dhe ta regjistroj në librat publike rrugë publike sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

15Nr. 346 - 34448
Lipjan, më 30. 06. 2016

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

